

UJITJA, KULLIMI DHE MBROJTJA NGA PERMBYTJET E TOKAVE BUJQESORE

Ujitja dhe kullimi janë një nga faktorët kryesorë me ndikim të drejtperdrejtë në rritjen e qëndrueshme të prodhimit bujqësor në vend.

Megjithëse rreshjet mesatare vjetore janë të bollshme, gjatë verës bien vetëm 20% e sasisë së tyre. Për të siguruar një bilanc optimal, është e domosdoshme ujitja me 3000-5000 m³/ha dhe kullimi, veçanërisht gjatë periudhës së dimrit, me një hidromodul 4-5 litra/sek/ha.

Infrastruktura e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet është e projektuar për ujitjen e rreth 420 000 ha tokë bujqësore (potencialisht të ujitëshme 360 000 ha), garantimin e kullimit në 280 000 ha dhe zvogëlimin e rrezikut nga përmbytjet lumore e detare. Zona më e rrezikuar nga përmbytjet është ultësira perëndimore e vendit.

Shqipëria është një vend i pasur me burime ujore, por për shkak të relievit të thyer, gjysma e ujit për ujitje sigurohet nga rezervuarët artificialë.

Për kullimin e një sipërfaqe prej 75 000 ha, funksionojnë 28 stacione pompimi (hidrovore) me fuqi të instaluar 28 000 kw dhe kapacitet mesatar të largimit të ujit 390 m³/sekond.

Synimet në këtë sektor konsistojnë në:

- Plotësimin e qëndrueshëm të nevojave për ujë, nëpërmjet rehabilitimit dhe modernizimit të sistemeve ujitës;
- Menaxhimin e qëndrueshëm të sistemeve të ujitjes nëpërmjet ndarjes së kompetencave dhe përgjegjësisve për operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e infrastrukturës së ujitjes, midis pushtetit qendror, komunave dhe organizatave të përdorimit të ujit;
- Garantimin e kullimit, me përparësi në ultësirën perëndimore, nëpërmjet rehabilitimit dhe përmirësimit të infrastrukturës egzistuese dhe rritjes së kapacitetit të hidrovoreve;
- Zvogëlimin e rrezikut nga përmbytjet lumore dhe detare, nëpërmjet rikonceptimit të strukturave mbrojtëse, duke konsideruar zhvillimet e reja urbane pranë lumenjëve dhe grykëderdhjeve të tyre.
- Menaxhimin e qëndrueshëm të sistemeve të kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet nga qeverisja qendrore duke synuar rritjen graduale të rolit, përgjegjësisve dhe kontributit të aktorëve dhe përfituesve lokalë.

Ligji nr. 8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, i ndryshuar me ligjin nr.9860, datë 21.01.2008, përcakton Ministrinë e Bujqesisë, si organin kryesor përgjegjës për administrimin e ujitjes dhe kullimit. Ndërsa administrimi i sistemeve kryhet përmes një ndarje të roleve dhe përgjegjësisve mes Bordeve të Kullimit dhe Organizatave të Përdoruesve të Ujit.

Aktualisht funksionojnë 13 Borde Kullimi, zonat e shërbimit të cilëve sipas ndarjes së kufijve administrativë të qarqeve, mbulojnë gjithë territorin e vendit.

Bordet e Kullimit janë struktura teknike të specializuara në vartësi të Ministrisë së Bujqesisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe financohen nga buxheti i shtetit.